



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN**

**Datë 08.11.2021**

**Dokument Parlamentar**

**RAPORT**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në 08.11.2021, ne cilësinë e Komisionit *që jep mendim* mori në shqyrtim Projektligjin “**Për Buxhetin e vitit 2022**” në parim.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Ministria për Ekonominë dhe Financat, e përfaqësuar nga Znj. Adela Xhemali, Zv. Ministre.

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2022*” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve) për vitin buxhetor 2022.

**Projektbuxheti i vitit 2022 synon konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19.** Projektbuxheti 2022 gjithashtu synon qëndrueshmërinë fiskale, e cila siguron qëndrueshmëri të financave publike shqiptare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, duke krijuar baza të forta për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. **Shpenzimet buxhetore për periudhën 2022-2024** do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqendruar në procesin e rindërtimit si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

**Projektbuxheti për vitin 2022 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për jetësimin e reformës në drejtësi**, përmes funksionalizimit të organeve të reja të drejtësisë si dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe miratimit të akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi. **Në shpenzimet e personelit për vitin 2022**, është parashikuar kosto aktuale e Administratës Publike, si dhe politika e re e rritjes së pagave kryesisht për sektorët e

shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes. Fondi vjetor për rritjen e pagave parashikon rritjen e pagës për funksion me 6 % për punonjësit shëndetësor dhe ata arsimorë.

**Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2022 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integrimit europian dhe të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Edhe në vitin 2022 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim.**

**Vazhdon të mbetet prioritet i Qeverisë Shqiptare për vitin 2022 nisja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, me mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare dhe avancimi i tyre në bazë të metodologjisë së re të procesit të negocimit me BE-në dhe gjithashtu avancimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit BE-Shqipëri. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integrimit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2022, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) për realizimin e këtij prioriteti si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive diplomatike për procesin e negociatave të anëtarësimit në BE**

### **1. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2020-2022**

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2021-2023, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë Shteteve Anëtare të BE-së.

### **2. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit**

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

#### **Legjislacioni parësor i BE-së:**

- *Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Pjesa e Gjashtë “Dispozita Institucionale dhe Financiare”, Titulli II “Dispozita Financiare”, Kreu 3 “Buxheti Vjetor i Bashkimit Europian”, Nenet 313-316; Kreu 5 “Dispozita të Përbashkëta”, nenet 320-324.*

#### **Legjislacioni dytësor i BE-së:**

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012”.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja (BE), Nr.2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe

miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë

### **Përfundime**

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2022*” nuk përafuron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Përsa i përket veprimtarisë së Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për ndryshimin e buxhetit. Pra buxheti i alokuar për procesin e integritetit evropian konsiderohet i mjaftueshëm.

Komisioni miratoi **në parim** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim.

**Relator**

**ETJEN XHAFAJ**

**KRYETARE**

**JORIDA TABAKU**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN**

**Datë 08.11.2021**

**Dokument Parlamentar**

**RAPORT**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”**

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në 08.11.2021, në cilësinë e Komisionit që jep mendim mori në shqyrtim Projektligjin “**Për Buxhetin e vitit 2022**” nen për nen.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit mori pjesë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, e përfaqësuar nga Znj. Olta Xhaçka, ministre.

Projektligji “*Për buxhetin e vitit 2022*” parashikon tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore (buxheti i shtetit) e vendore (buxheti vendor) dhe të fondeve speciale (sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i ish-pronarëve) për vitin buxhetor 2022.

**Projektbuxheti i vitit 2022 synon konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike të vendit pas dy fatkeqësive natyrore si tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e shkaktuar nga COVID-19.** Projektbuxheti 2022 gjithashtu synon qëndrueshmërinë fiskale, e cila siguron qëndrueshmëri të financave publike shqiptare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, duke krijuar baza të forta për një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. **Shpenzimet buxhetore për periudhën 2022-2024** do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqendruar në procesin e rindërtimit si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

**Projektbuxheti për vitin 2022 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për jetësimin e reformës në drejtësi**, përmes funksionalizimit të organeve të reja të drejtësisë si dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe miratimit të akteve nënligjore për zbatimin e reformës në drejtësi. Në **shpenzimet e personelit për vitin 2022**, është parashikuar kosto aktuale e

Administratës Publike, si dhe politika e re e rritjes së pagave kryesisht për sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe mbrojtjes. Fondi vjetor për rritjen e pagave parashikon rritjen e pagës për funksion me 6 % për punonjësit shëndetësor dhe ata arsimorë.

**Në planifikimin e investimeve publike për vitin 2022 janë mbajtur gjithashtu në konsideratë prioritetet e integrimit europian** dhe të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Edhe në vitin 2022 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim.

**Vazhdon të mbetet prioritet i Qeverisë Shqiptare për vitin 2022 nisja e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, me mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare** dhe avancimi i tyre në bazë të metodologjisë së re të procesit të negocimit me BE-në dhe gjithashtu avancimi i zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit BE-Shqipëri. Në kuadër të mbështetjes së procesit të integrimit të vendit në BE, projektbuxheti i vitit 2022, parashikon mbështetjen e veprimtarisë së **Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)** për realizimin e këtij prioriteti si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive diplomatike për procesin e negociatave të anëtarësimit në BE

### **3. Plani Kombëtar për Integrimin Europian (PKIE) 2020-2022**

Ky projektligj nuk është i parashikuar në PKIE 2021-2023, sepse kjo fushë nuk është e harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ajo mbetet kompetencë e vetë Shteteve Anëtare të BE-së.

### **4. Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit**

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor.

#### **Legjislacioni parësor i BE-së:**

- *Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit Europian (TFBE): Pjesa e Gjashtë “Dispozita Institucionale dhe Financiare”, Titulli II “Dispozita Financiare”, Kreu 3 “Buxheti Vjetor i Bashkimit Europian”, Nenet 313-316; Kreu 5 “Dispozita të Përbashkëta”, nenet 320-324.*

#### **Legjislacioni dytësor i BE-së:**

- Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 18 Korrik 2018 “Mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr.1296/2013, (BE) Nr.1301/2013, (BE) Nr.1303/2013, (BE) Nr.1304/2013, (BE) Nr.1309/2013, (BE) Nr.1316/2013, (BE) Nr. 223/2014, BE Nr.283/2014 dhe Vendimin Nr. 541/2014/BE dhe shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom), Nr 966/2012”.

Legjislacioni parësor (Nenet 313-316 dhe 320-324 të TFBE-së) dhe dytësor i BE-së (Rregullorja (BE), Nr.2018/1046), përmban vetëm rregullat lidhur me hartimin dhe miratimin

e buxhetit vjetor të Bashkimit Europian, por nuk parashikon rregulla lidhur me hartimin dhe miratimin e buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së. Për pasojë, hartimi dhe miratimin i buxhetit nga Shtetet Anëtare të BE-së është kompetencë ekskluzive e këtyre shteteve, të cilat kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që ato i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë

### **Përfundime**

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2022” nuk përafuron ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të BE-së, por rregullon çështje të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të Shteteve Anëtare të BE-së nuk është i harmonizuar në nivel të BE-së, dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në miratimin e akteve ligjore që i gjykojnë të nevojshme në këtë fushë.

Përsa i përket veprimtarisë së Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për ndryshimin e buxhetit. Pra buxheti i alokuar për procesin e integritimit europian konsiderohet i mjaftueshëm.

**Komisioni për Integrimin Europian, duke konsideruar që Republika e Shqipërisë është në pritje të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për fillimin e procesit të negociatave, duke u bazuar edhe në Metodologjinë e re të Komisionit Europian 2020 (të ndryshuar) konsideron që procesi i integritimit në përgjithësi dhe i negociatave në veçanti kërkon organizim të konsoliduar si në burime njerëzore ashtu edhe strukturore. Komisioni për Integrimin Europian konsideron buxhetin e alokuar për procesin e integritimit europian në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme të pamjaftueshëm për realizimin e përparësive të procesit të integritimit europian.**

**Për sa më sipër, Komisioni për Integrimin Europian kërkon një rritje prej 7 % të vlerës së alokuar për procesin e integritimit Europian në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme duke marrë si bazë buxhetin e vitit 2021 për zërin si vijon:**

01150	Mbeshtetja Institucionale për Procesin e Integritimit
-------	---

Komisioni miratoi **nen për nen** me shumicë votash projektligjin në shqyrtim me kërkesën për rritje të buxhetit prej 7 % si më sipër

**Relator**

**ETJEN XHAFAJ**

**KRYETARE**

**JORIDA TABAKU**